

W  
UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration Intérimaire  
des Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**TRANSKRIPT**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 27 NËNTOR 2002**

**TRANSKRIPT**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 27. NOVEMBRA 2002.**

---

**NËNTOR - NOVEMBAR**

**2002**



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Revised version / Verzioni I koriguar / Коригирана верзија

**RENDI I DITËS**

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar
- 3.(1) Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pylltari të Kosovës (2002/10)
- 3.(2) Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për aktivitetet e tregtisë me jashtë (2002/6)
- 3.(3) Rekomandimet e Këshillit gjyqësor dhe i prokurorëve për emrin e gjyqëtarve dhe prokurorëve
4. Parashtrimi i pyetjeve

---

Vrejtje : Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë

“Pjetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashresa të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.  
(Rregulla 19.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

**ДНЕВНИ РЕД**

Дневни ред:

1. Усвајање дневног реда
2. Записник од претходне седнице
- 3.(1) Прво разматрање Нацрта закона о шумарству Косова (2002/10)
- 3.(2) Друго разматрање Нацрта закона о активностима спољне трговине (2002/6)
- 3.(3) Препоруке судског веча и тужиластва за именовање судија и тужиоца

## TRANSKRIPT

### NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27 NËNTOR 2002

Seanca filloi në orën 10,15.

Seancën e kryesoi Akademik Prof. Dr. Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit.

#### KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes kolegë deputetë. Mirë se keni ardhur në Seancën e rregullt plenare. Unë do të kërkoj që ta aprovojmë agjendën e punës për sot të cilën shpresoj se e keni marrë me kohë.

Nëse ka ndokush diç, le të urdhërojë. Urdhëroni, zoti Dugolli.

#### BUJAR DUGOLLI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,  
Mendoj se ky rend i ditës mund të shkojë, por përveç kësaj, unë kërkoj nga kryetari i Kuvendit që t'na japë një sqarim lidhur me takimin paradoditësh që ka ndodhur në Zvicër. Nga shumkush është quajtur se ka qenë takim sekret, i paplanifikuar, i paorganizuar dhe mendoj se dëshirojmë t'i marrim informacionet nga burimi, nga dora e parë, sepse nuk kemi pasur ndonjë seancë të mëhershme e që t'i diskutojmë dhe se ka munguar bashkëpunimi apo kontakti i Kryesisë, i kryetarit të Kuvendit me grupet parlamentare për t'na e sqaruar këtë çështje. Dhe, mendoj se kemi të drejtë ta kërkojmë një sqarim lidhur me këtë çështje. Kjo është nën një.

Ndërsa, nën dy - kërkoj që ky Kuvend sot të diskutojë rrëth situatës në arsimin e lartë. Konkretnisht rrëth grevës që janë duke e mbajtur studentët e Universitetit të Prishtinës dhe mos ta lëmë që t'na kalojë ashtu, sepse deri në javën e ardhshme, nëse e lëmë për të diskutuar, situata mund t'na rëndohet dhe mund të vijmë në pozicionin siç kemi ardhur kur ishte greva e arsimtarëve dhe kur e neglizhuam erdhi deri te ajo gjendje saqë humbëm me javë të tëra të mësimit për ta marrë një vendim dhe mendoj se duhet t'i paraprijmë këtyre zhvillimeve si institucione dhe t'i rishikojmë ato vendime a janë të drejta dhe a mund të janë të përballueshme për studentët dhe në fund t'ia japim një sygerim Ministrisë se çka duhet të veprojë. Mendoj se është në interes të përgjithshëm

që të mos bllokohet puna në Universitet dhe kërkoj që kjo çështje të hyjë në rend të ditës. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. E ka fjalën profesor Alush Gashi.

### **ALUSH GASHI:**

Inderuari kryetar, zonja dhe zotrinjë,

Duke mbështetur propozimin për rendin e ditës, dal me një kërkesë, nëse jo sot, në një prej seancave të ardhshme të hyjë në rend të ditës me sa vijon. Thotë: "Me miratim të ligjeve Kuvendi i Kosovës krijon parakushte për vazhdim të zhvillimit të Kosovës dhe jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e saj, por për këtë nevojitet një punë shumë më intensive dhe një efikasitet i shtuar i Kuvendit të Kosovës e në veçanti i Kryesisë dhe Sekretariatit të Kuvendit të Kosovës". Është në mandat të Kuvendit të Kosovës të kërkojë llogari nga institucionet e dalura nga Kuvendi. Nga kryetari i Kuvendit kemi dëgjuar shumherë se së shpejti do të jetë në rend të ditës edhe çështja e funksionimit të Kuvendit, por kjo nuk ndodhi ende.

Andaj, zotëri kryetar, kërkoj që sa më parë të jetë në rend të ditës të këtij Kuvendi puna e Kryesisë, e Sekretariatit të Kuvendit si dhe raporti i Qeverisë së Kosovës për punën e deritanishme.

Duke ju falënderuar për vëmendje, mbetem me shpresë se debati në Kuvend do të ndihmojë në shtim të efikasitetit të organeve të sipërpërmendura. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Të falemnderit. E ka fjalën Ramadan Kelmendi.

### **RAMADAN KELMENDI:**

Inderuari kreytar, të nderuar deputetë dhe ministra,

Duke u gjend në fazën e aprovizimit të rendit të ditës, mendoj se është shumë e arsyeshme që sot ne të kemi një informatë nga Qeveria e Kosovës lidhur me Urdhëresën administrative të Përfaqësuesit Special të OKB-ës Nr. 2002/26 lidhur me shtrirjen e pushtetit të UNMIK-ut mbi Mitrovicën veriore, të ashtuquajtur dhe se çka përban kjo urdhëresë e do të ishte mirë që edhe ne si deputetë ta kemi dhe të jemi në dijeni çka po ndodhë në Mitrovicë. Të gjitha rezultatet e tanishme tregojnë se atje po krijuhet një komunë e re mbi baza etnike serbe, përkundër faktit se është publikuar në mënyrën më pompoze se Mitrovia po integrohet, gjegjësisht po bashkohet.

Si deputet, dorë e parë jemi ata që duhet të informohemi dhe vërtetë do të ishte mirë që të informohemi lidhur me këtë që po ndodhë, ngase nuk shoh elemente pozitive rrëth integrimit të qytetit të Mitrovicës, nga fakti se edhe qeveria e Beogradit është deklaruar

se kjo është një marrëveshje e arritur në mes UNMIK-ut dhe të tyre. Ndërsa, përfaqësuesit e UNMIK-ut kanë dekluaruar se nuk është kurrfarë marrëveshje e arritur paraprake por është një realizim i programit të tyre.

E dyta, mendoj se nga Kosova një numër shumë i madh i delegatëve gjegjësisht delegacioneve kanë udhëtar për në Amerikë, Shqipëri, Gjermani, Kroaci, Slloveni dhe deri më tani ne nuk kemi asnjë informatë mbi takimet e tyre qofshin ato bilaterale apo multilaterale gjegjësisht mendoj se këto takime duhet të prezantohen në këtë Kuvend dhe si të tilla të kenë edhe një mendim paraprak edhe të kryetarit të Kosovës dhe të kryetarit të Komisionit për bashkëpunim ndërkombëtar. Të gjitha këto na çojnë nga ajo që ne të jemi të informuar edhe për takimet e përfaqësuesve shqiptarë që kanë mbajtur atë takim në Lucern, siç u quajt, duke e përkrahur edhe atë. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Zoti Ismajl Kurteshi, pastaj Muhamet Kelmendi.

#### **ISMAJL KURTESHI:**

Kryesi e nderuar, deputetë të nderuar,  
Para dy-tri ditesh, forcat kufitare maqedonase janë futur dy kilometra në territorin e Kosovës dhe me atë rast e kanë plagosur vajzën nëntëvjeçare Nurije Bajrami, nga fshati Stançiq i komunës së Gjilanit. Raste të ngjashme ka pasur edhe më herët në të kaluarën. Unë me këtë rast kërkoj nga Kryesia e Kuvendit që të kontaktojë me KFOR-in, me UNMIK-un por edhe me organet e Maqedonisë që të pamundësohen cenime të tillë të territorit dhe rrezikimit të jetës së qytetarëve të Kosovës, brenda territorit të Kosovës.

Po ashtu, propozoj që sot të futet në rend të ditës për diskutim vendimi i zoti Shtajner në lidhje me monitorimin e Kuvendit të Kosovës nga OSBE-a. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Zoti Muhamet Kelmendi.

#### **MUHAMET KELMENDI:**

I nderuarai zoti kryetar, zonja dhe zotrinjë,  
Në fakt, në pikë të shkurtëra të gjitha çështjet edhe u paraqitën, por ajo, çka është më kryesore, është pikërisht çështja e monitorimit, të cilin me një urdhër, ose me një vendim të kryeadministratorit të Kosovës, përcaktohet një mekanizëm ose instrument juridik, siç e qujmë ne, mbi këtë Kuvend, që për momentin na duket shumë i thjeshtë, i parëndësishëm, por kur ta marrim për bazë mënyrën e intervenimit nga ka ardhë dhe formës se kah mund të na çojnë format e tillë të intervenimit, na del se mund të na sjellë deri tek situata që Kuvendi të ketë vështirësi të funksionimit të vet. Në anën tjetër, kemi të bëjmë me një vendim ose me një mjet juridik, instrument juridik, i cili është në

kundërshtim drejtpërsëdrejti me Kornizën kushtetuese, në kundërshtim me Rregulloren e përkohshme të Kuvendit të Kosovës dhe nuk mund ta gjejë askush asnjë bazë juridike mbi të cilën mund të vendoset instrumenti i monitorimit të Kuvendit. Nesër a pasnesër do të dilet me kërkesa tjera dhe të shkohet deri atje që Kuvendi mos të funksionojë.

Çështje e dytë, është çështja se si Kuvendi edhe Qeveria e Kosovës, nuk duhet të lejojnë, për mendimin tim, që të manipulohet nëpër mjete të informacionit e të thuhet se: kanë filluar bisedimet - jo nuk ka pasë bisedime; ka pasë kontakte – jo nuk ka pasë kontakte. Shkruhet ndonjë letër e tutje dhe veprohet në forma të tilla. Mendoj se Kuvendi situatat e tilla duhet t'i përcjellë dhe Kryesia është e obliguar që menjëherë të thërras seanca qoftë edhe të jashtëzakonshme për t'i shqyrta rastet e tilla, për t'iu sqaruar deputetëve dhe qytetarëve të Kosovës e jo për t'i lënë përmes mjeteve të informacionit, me shkëmbime të letrave dhe formave të tjera e të bëhet informacioni i tillë.

Në anën tjetër, e kemi punën e Qeverisë, ku pothuaj që nga momenti i themelimit të saj, përveç një raporti ose një vijëzimi politik kah do të shkojmë dhe nuk e kemi fare në dijeni punën e tyre. Nuk vijnë këtu për të raportuar për punën as tremujore e gjashtëmujore, nuk e dijmë ministritë çka bëjnë, nuk e dijmë kah shkon situata, mësuesit dhe arsimtarët çohen në greva, premtohet rritje e të ardhurave dhe në fund s'realizohet asgjë; nxjerren urdhëresa të tjera, për të cilat, me të drejtë sot u paraqit se duhet të merret qëndrim i tillë lidhur me grevën e studentëve të Univeristetit të Prishtinës dhe megjithatë Ministria e Arsimit nuk e sheh të arsyeshme që të vjen këtu të deklarojë dhe të shpjegojë për situatën dhe si duhet të ecim dhe kah duhet të shkojmë. Pra, mendoj se kjo është një situatë jashtëzakonisht urgjente dhe si e tillë duhet në mënyrë urgjente të shtrohet në Kuvend dhe të merret në shqyrtim sepse me të vërtetë nuk duhet të lejojmë e të delë situata nga dora.

Mendoj se me këto çështje, dhe jo vetëm duke dhënë shpjegime pör duke i futur në rend të punës, në qoftë se është nevoja të ndalemi edhe tri ditë në Kuvendin e Kosovës për të punuar sepse është bërë edhe një punë, një praktikë jo e rëndomt ose për mendimin tim jonormale që vetëm të enjteve të takohemi. Në kuvendet tjera fillojnë seancat të enjten e vazhdojnë të premtën, të shtynën e të dielen, katër ditë pandërprerë me punë dhe rend të ngjeshur të ditës dhe jo që për çdo seancë një herë në javë të enjten të thirremi.

Prandaj, mendoj se duhet ta shtojmë rendin e tillë të punës e në qoftë se është nevoja të vazhdojmë, jo me 28 nëntor se është Ditë e festës kombëtare e gjithë popullit shqiptar pavarësisht se ku janë dhe nga ky vend ua uroj të gjithëve këtë festë, por të vazhdojmë ditën e premte dhe të shtune.

Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Besa Gaxherri e ka fjalën.

## **BESA GAXHERRI:**

Inderuari kryetar, të nderuar deputetë,  
Mendimin tim gati e tha kolegu nga Grupi parlamentar i PDK-ës, vetëm kam për të shtuar se unë përkrahu rendin e ditës, por vërtetë kur ky Kuvend lëshoi Rezolutën për mosnjohjen e marrëveshjes, apo për pazaret e Serbisë dhe të Maqedonisë që bënин për kufirin e Kosovës, organet ndërkombëtare që veprojnë këtu në Kosovë atë Rezolutë e shpallën si të pavlefshme, ndërsa tanë ne jemi dëshmitarë të fillimit të eksceseve në kufirin tonë dhe veç kemi viktimën e parë. Prandaj, unë kërkoj nga ky Kuvend që përvèç se të dënohet rasti të fillojmë procesin dhe të punojmë në këtë drejtim dhe mua më intereson ku do të jemi ne si Kosovë në takimin që do të mbahet në Maqedoni e të diskutohet pikërisht kufiri në mes Maqedonisë dhe Kosovës. Ju falemnderit.

## **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Unë mendoj se paraqitja kaq e madhe e deputetëve për të debatuar për agjendën e punës tregon shqetësimet e përgjithshme dhe individuale të Parlamentit tonë dhe në të njëjtën kohë tregon ndërlíkueshmërinë në të cilën veprojnë institucionet në Kosovë. Dhe, deputetë të nderuar, kthehuni rrëth veti e shiqoni sa jemi numerikisht në sallë! Sa mirë është e sa bukur duket kur një kryetar partie ose një deputet propozon të punohet trikatër ditë, ndërsa, kur të kthehem me pa vetë sa kohë kemi qenë në Parlament dhe në seanca plenare – do t'i shofim rezultatet! A është koha që të bisedohet dhë të jipet përgjegjësi dhe raport për punën e Kryesisë, të kryetarit, të komitetave, të komisioneve e të Qeverisë – është koha. Dhe është koha, po ashtu, të mbahet një evidencë shumë e quartë për praninë e deputetëve në seanca plenare dhe në punën e komisioneve. Të gjitha këto tregojnë se shumë shpejt, do të thotë gjatë dhjetorit, duhet të vëhen në rend të ditës të gjitha këto probleme të grumbulluara dhe atë vetëm me një pikë të rendit të ditës: Gjendja në Kosovë dhe veprimi i institacioneve të Kosovës.

Sot, unë do t'ju lutja që ta aprovojmë agjendën dhe pastaj do të shohim se... Leximi i parë i Ligjit për pyjet prapë duhet të shtyhet, sepse Qeveria nuk është e pranishme, do të thotë resori përkatës nuk është i pranishëm. Atëherë, le të punojmë sipas agjendës dhe lidhur me atë që e propozoi zoti Dugolli në emër të Aleancës, unë do të thoja që është bërë mjaft transparente Konferenca në Lucern. Unë e kam informuar Kryesinë dhe propozoj, meqë është e incizuar ajo mbledhje, të gjithë deputetëve t'u dërgohet e tërë ajo që është thënë në Kryesi dhe ta kenë në postë e të mos humbim kohë me këtë, sepse është thënë në media, kurse unë propozoj që deputetët të njihen fjalë për fjalë për atë që është thënë në Kryesi dhe ta keni informatën.

Jemi para festës dhe një numër veç kanë kërkuar leje dhe ata edhe ashtu do ta lëshojnë më herët. Është një ligj që e shtyjmë që disa herë dhe është edhe ministri këtu, prandaj ju lutemi ta aprovojmë agjendën e propozuar dhe temat tjera, secila në kohën e vet, nuk mund të ikën e as që dëshiron askush t'i ikën debatimeve, por në mënyrë të përgatitur. Po ju them se zgjedhjet kanë përfunduar, seancat plenare nuk duhet t'i shfrytëzojmë për

marketing politik individual ose të partive politike. E kemi mbajt një takim me të gjitha komisionet dhe të njëjtën lutje kryetarëve të komisioneve ua kemi bërë. Jemi plotësisht dakordë që secili t'i rrespektojë përgjegjësitë e veta dhe nëse është e dëshirueshme të hyjmë edhe në revokime dhe shkarkime. Pse jo. Kemi hyrë në demokraci. Prandaj, përtatua ruajtur një efikasitet kohor, do t'ju lutja që të procedojmë me agjendën e cila është përgatitur edhe nga Kryesia dhe të procedojmë sipas agjendës së rendit të ditës, pa e mënjanuar asnjë shqetësim të asnjë deputeti përtë gjitha çështjet që janë parashtruar.

Unë mendoj se mund të procedojmë sipas rendit të ditës, ju lutem. Ju falemnderit.

Pika e dytë e rendit të ditës është: Procesverbal. Besoj se këtë e keni marrë. Urdhëroni zoti deputet.

#### **HASAN META:**

Zoti kryetar, e nderuara Kryesi, të nderuar deputetë,  
Unë kam pritur që të ketë ndonjë reagim nga Komisioni për bujqësi, pylltari e këto tjera për mosardhjen e ministrit në seanca të Kuvendit dhe mendoj se është e nevojshme që ajo gjë të diskutohet këtu dhe deri kur mund të na zhagisë një njeri i tillë i cili nuk dëshiron të vijë, ndoshta për shkaqe të ndryshme dhe si t'ia bëjmë asaj pune. Unë mendoj se është koha që të vetëdijësohem pak e jo kështu të kalojmë në heshtje për të gjitha këto gjëra. Nuk mund të jemi peng të invividëve apo të grupeve që nuk janë në interes të Kosovës dhe të qytetarëve të Kosovës. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Unë besoj se të gjithë jemi të një mendimi. Kryesia në mbledhjen e parë të ardhshme do të kërkojë nga Qeveria që të caktojë një njeri përgjegjës i cili do të referojë në emër të atij që nuk dëshiron të jetë i pranishëm. Prandaj, pajtohem plotësisht me shqetësimet tuaja. Urdhëro zoti Tomë Hajdaraj, kryesues i Komisionit.

#### **TOMË HAJDARAJ:**

Kolegë të nderuar,  
Sa i përket Ligjit në fjalë, i cili po zhagitet, ne kemi paraqitur shqetësimin tonë që nga versioni i punës e jo nga futja e draftit në procedurë. Unë mendoj dhe plotësisht pajtohem me atë që tha kryetari dhe është e udhës që t'i drejtohami Ministrisë përkatëse që të caktojë njeriun e autorizuar i cili do ta paraqesë gjegjësish të mbrojë projektin në seancat e ardhshme sepse, në të kundërtën, të jeni të bindur, po ma merr mendja që pylltaria do të thotë gjegjësish gjysma e tokës së Kosovës po shkatërrrohet në mënyrë të pamëshirshme. Sa i përket punës së Komisionit, me përgjegjësi shumë të madhe ju njoftoj se ne kemi mbajtur katër takime lidhur me këtë ligj dhe e kemi diskutuar edhe nen për nen, e këtu janë edhe kolegët prezent dhe jemi marrë vesh dhe kemi pritur që sot do të jetë ministri apo përfaqësuesi i Ministrisë që të mbrojë projektin e ofruar

Kuvendit të Kosovës, por për fat të keq ai nuk ka ardhur dhe unë nga ky vend edhe një herë insistoj, bile-bile në fillim jemi bë tepër si Komision duke kërkuar dhe duke pasur drojen se do të ndodhin këso koncesionesh në rrjedhat e mbarëvajtjes së punës në të gjitha lëmitë e jo vetëm të pylltarisë, por pylltaria përmomentin ka një aksent të posaçëm. Andaj, edhe unë i bashkëngjitem mendimit të kryetarit që javën e ardhshme përfaqësuesi i Ministrisë së Bujqësisë të prezentojë këtu pa marrë parasysh... sepse ne nuk bëjmë ligj përmirësuesi i Ministrisë së Bujqësisë, nuk bëjmë ligj përmirësuesi i agjencionit apo si do të quhet. Ne bëjmë ligj përmirësuesi i menaxhimin me pyjet e Kosovës si pasuri natyrore të Kosovës, si pasuri strategjike në të gjitha nivelet përmirësuese mbarkosovare. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Në rend dite është procesverbal. A ka ndokush diç lidhur me këtë ndonjë vërejtje apo siç jemi marrë vesh vërejtjet të dorëzohen me shkrim në mënyrë që të përmirësohen në gjendje të plotë.

Ju falemnderit. Meqë nuk mund të kalojmë në shqyrtimin e parë të Ligjit mbi pylltarinë, unë do t'i lus tri komisionet dhe do të japim një pauzë 30 minutash. Tre komisionet që janë të rëndësishme përmirësuesi i shqyrtimin e dytë të Ligjit përmirësuesi i tij, me qëndrimin që t'i harmonizoni një nen apo dy që janë, një diskrepancë në mes të qëndrimit të Qeverisë dhe të Zyrës legale të UNMIK-ut në mënyrë që më shpejt pastaj të procedojmë sepse është një befasi, nuk mund ta quaj e këndshme apo e pakëndshme, më tepër ka amendamente sesa nene të ligjit. Ju falemnderit dhe takohemi pas pauze 30 minutash.

**(Pason pauza prej 30 minutash)**

**(Pas pauzes, seanca vazhdoi punën)**

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Shpresoj se të gjitha komisionet janë kthyer në Seancë plenare, prandaj mund të vazhdojmë me pikën e rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Ligjit përmirësuesi i tij, me qëndrimin që t'i harmonizoni një nen apo dy që janë, një diskrepancë në mes të qëndrimit të Qeverisë dhe të Zyrës legale të UNMIK-ut në mënyrë që më shpejt pastaj të procedojmë sepse është një befasi, nuk mund ta quaj e këndshme apo e pakëndshme, më tepër ka amendamente sesa nene të ligjit. Ju falemnderit dhe takohemi pas pauze 30 minutash.

Komisionet i kanë kryer punët dhe kjo pauzë ka qenë vetëm në një nen ku ka pasë diskrepanca në mes të dy zyreve ligjore të Qeverisë dhe të UNMIK-ut prandaj le të shkojmë me radhë dhe mendoj se deputetët me kohë i kanë marrë amendamentet dhe i kanë studiuar, prandaj ju lus të procedojmë me radhë.

Zyra e kryeministrat dhe Zyra ligjore nga UNMIK-u:

Nën 1, Preamble, paragrafi i dytë, thotë: të shtohen në vijim pas fjalës “veçanërisht” “më tej Korniza kushtetuese”;

Urdhëroni, kryetar i Komisionit je. Unë mendova se i keni harmonizuar dhe desha të fitojmë në kohë.

### **BAJRUSH XHEMAJLI:**

Kryesi e nderuar, ministra dhe deputetë kolegë të nderuar,  
Sa u përket vërejtjeve në Projektligj, ne në Komisionin tonë për tregti, industri i kemi dhënë me kohë e nuk janë të shumta dhe ato vërejtje veç i kemi dorëzuar moti në postën e deputetëve. Po theksoj se sygjerimet tona i kemi votuar unanimisht në Komision, me përjashtim të dy anëtarëve të Koalicionit “Kthimi” të cilët edhe pse kanë qenë prezent nuk kanë marrë pjesë në shqyrtimin e Projektligjit për shkak të qëndrimit të tyre politik, me paralajmërim se atë që kanë për ta thënë do ta thonë këtu në Seancën plenare si koalicion gjë që veç e kanë bërë dhe dihet se e kanë lëshuar sallën, nuk morën pjesë në shqyrtim.

Vlerësimi ynë për Projektligin është një vlerësim i kënaqshëm, mendoj një projektligj i kënaqshëm dhe atyre propozimeve që ne i kemi dhënë nuk kemi çka t'u shtojmë si Komision. Ndërkaq, më duhet të theksoj se Komisioni nuk i ka shqyrtuar më herët, duhet të them, komentet e UNMIK-ut të dalura nga Zyra ligjore e zotit Shtajner e as komentet e Zyrës ligjore të Kryeministrisë lidhur me komentet e UNMIK-ut. Ne nuk kemi bërë shqyrtimin e atyre komenteve sepse kemi konsideruar që para se gjithash Komisioni duhet ta shqyrtojë Projektligin që është dalë këtu para kuvendarëve dhe të merrë qëndrim ndaj amendamenteve të tij e jo të merrë qëndrim ndaj komenteve të Zyrës ligjore apo komenteve të komenteve, do të thotë komentet e Qeverisë por edhe komentet e Zyrës ligjore, siç është kërkuar nga ne. Pastaj, edhe po të donim ne nuk kemi mundur të marrim qëndrim lidhur me to pasi që dy zyret ligjore, ajo e zotit Shtajner dhe ajo e kryeministrit janë kundërshtuar njëra me tjetër dhe deri dje nuk kanë mund t'i harmonizojnë si qëndrime të përbashkëta dhe atë material nuk e kemi pasur ne deri më sot këtu. Tani, siç e patë, i kemi marrë duke hyrë materialet dhe ne u tubuam. Komisioni ynë, menduan do të tubohemi së bashku të gjitha komisionet që thatë, por s'di, të tjerët menduan që më mirë do të jetë të jemi ndaras. Ne, Komisioni për tregti e industri e kemi mbajtur veç dhe me ne ka qenë edhe përfaqësuesja e Komisionit për ekonomi e financa si e vetme që ishte këtu dhe mendoj ajo e ndanë mendimin që e kemi ne këtu.

Këto amendamente nuk mendojmë se Komisioni duhet t'i shqyrtojë tash. Amendamentet qoftë të komisioneve apo të organeve tjera kemi menduar nuk është koha që këtu t'i shqyrtojmë ad hoc ne. Kjo është çështja, parlamentarë të nderuar, ne ashtu kemi menduar dhe kaq është sa i përket mendimit tonë për atë që biseduam aty.

Unë, megjithatë, këtu dua të flas edhe në emrin tim, si deputet, lidhur me këtë sepse ka qenë një maratone e tërë derisa ky ligj ka dalur këtu dhe jam përballur mendoj me të që prej fillimit. Konsideroj se në këtë fazë, ndërhyrja në këtë mënyrë kaq të vrazhdët e UNMIK-ut ka injoruar punën e parlamentarëve dhe është ndërhyrje që nuk ka të drejtë ta bëjë UNMIK-u, unë mendoj kështu, Zyra ligjore e zotit Shtajner. Ka mund të ketë

qasje dhe t'i japë vërejtjet e veta në fazën përgatitore të Projektligjit e jo tanë kur jemi në fazë kur shqyrtimin e dytë duhet ta bëjnë parlamentarët. Tani fjalën do të duhej ta kishin komisionet përkatëse dhe deputetët e jo Zyra ligjore. Në këtë fazë ka mund të ndërhyjë vetëm nëse nga shqyrtimet e parlamentarëve, qoftë nga, po mendoj, komisionet apo si ndonjë parlamentar është propozuar ndonjë amendament i cilë prekë apo cenon kompetencat e UNMIK-ut. Në këtë fazë, po, ka mund të hyjë, por kjo nuk ka ndodhë. Megjithkëtë, UNMIK-ut ka ndërhyrë me 29 komente gjë që ka prekur 120 çështje në Projektligj dhe në fakt aq ndryshon Projektligji sa që, mund të them lirisht, nuk është ai ligji që e kemi aprovuar në parim në shqyrtimin e parë ne këtu. Ky është një projektligj mendoj tash me ndryshime tepër-tepër të mëdha. Komentet kanë të bëjnë kryesisht me atë se gjoja kompetencat që i takojnë UNMIK-ut me këtë projektligj u mohohen, do të thotë u mohohet UNMIK-ut. Në fakt, është e kundërta. Më këto komente, vendorëve u mohohet ajo që iu takon edhe me Kornizën kushtetuese. Në kreun 5, neni 5.1. ku shkruan për përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes nën (q) thuhet se: "kanë përgjegjësi edhe në fushën e tregtisë së brendshme dhe të jashtme, në industri dhe në investime" e tjera. Prandaj, së paku personalisht, si deputet i këtij Parlamenti, nuk do t'i pranoja ato komente që tanë na i kanë sjellur si amendamente, por është çështje sigurisht e të gjithë deputetëve a i pranojnë apo jo. Për këtë, duhet të shtoj, jam i autorizuar edhe prej Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit zoti Xhemajli. Para se t'ju jap fjalën, ju lutem një sqarim. Ju kujtohet që Ligji në parim në këtë Parlament është aprovuar. Detyra jonë është që t'i shqyrtojmë vetëm propozimet që kanë ardhur të formuluara si amendamente nga të gjithë ata që e kanë të drejtën legale me i pru si amendamente. Ato i kemi të shkruara. Unë e kuptova kryetarin e një Komision... Zoti Shatri ju lutem nuk është kohë për debate as në parim as të përgjithshme. Për hirë të efikasitetit të kontributit të punës në Ligj, të shkojmë në shqyrtim të amendamenteve. Urdhëro, zoti Shatri, si kryesues i Komisionit.

#### **HAKI SHATRI:**

Ju falemnderit, zoti kryetar.

Unë nuk do të debatoj por do ta them qëndrimin e Komisionit për buxhet lidhur me materialin që e morëm drejtpërdrejt para fillimit të seancës e që ka të bëjë me Ligjin që e kemi në rend të ditës. Komisioni për buxhet, ashtu si e mori obligimin, u mblođh në pauzë dhe nxori këtë përfundim:

Për shkak të momentit të shpërndarjes, numrit, përbajtjes dhe dilemave që po sjellin këto amendamente të ofruara drejtpërdrejt para fillimit të seancës dhe pa prezantimin e arsyeshmërisë së tyre të përfaqësuesit të Qeverisë, gjegjësisht ministrit të tregtisë dhe industrisë dhe pa prezantimin e përfaqësuesit të Qeverisë dhe arsyetimin e këtyre amendamenteve para Komisionit, Komisioni mori vendim që t'i propozojë Kuvendit që Ligjin e shtruar për diskutim ta miratojë me vërejtjet, propozimet gjegjësisht amendamentet e pranuara nga komisionet përkatëse dhe atë: për buxhet, për të drejtat

dhe interesat e minoritetave, të Komisionit për tregti, industri dhe ekonomi e financa, të cilat me procedurë të rregullt janë shqyrtuar dhe miratuar.

Amendamentet e ofruara sot Komisioni për buxhet nuk i ka miratuar për shkaqe objektivisht të njohura këtij Kuvendi. Marrja me vonesë dhe jashtë procedure e amendamenteve, nuk mundësoi vlerësim objektiv të tyre nga Komisioni për buxhet, kurse Kuvendin dhe vetë Komisionin e ka vënë para një pozite tepër të keqe.

Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Të falemnderit, zoti Shatri. Zoti Fatmir Rexhepi, por s'e di për ç'arsye... komisionet po.

### **FATMIR REXHEPI:**

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra,  
Si një anëtar i Komisionit, që kemi punuar shumë, do të thotë, gjatë shqyrtimit të këtij projektligji dhe këtu dola edhe për arsyen se gjatë këtij muaji janë bërë mjaft propaganda rrëth këtij ligji dhe kërkoi, do të thotë, atë përgjegjësinë se te kush është kjo vonesë dhe pse u bë. Sepse komisionet, nga këtu është thënë, nuk po punojnë, po i vonojnë projektligjet, nuk po i shqyrtojnë si duhet e tjera, e tjera nëpër deklarata të ndryshme. Prandaj po e them me plot përgjegjësi këtë se lidhur me projektligjin, do të thotë, propozimligji është në harmoni të plotë me kreun 5 dhe paragrafet përcjellëse, do të thotë 5.6 dhe 5.7 të cilat janë në Kornizën kushtetuese dhe që përcaktojnë veprimtarinë e institucioneve të Kosovës në këtë fushë. Ligji në fjalë, edhe një herë po e them, ofron zgjidhje të mirë për problemet në këtë fushë në Kosovë, edhe pse këto i kemi shqyrtuar në parim herën e parë, por e kanë komplikuar punën ndërhyrja e Zyrës së UNMIK-ut dhe e kanë komplikuar punën dhe procedurën ndërhyrja e Zyrës së kryeministrat dhe atë me dy zyrtarë. Kemi pasur ne debate rrëth kësaj në Komision. Vjen një zyrtar ndërkombëtar që flet diçka, diçka tjeter i kryeministrat e po ashtu vjen një zyrtar shqiptar i cili flet diçka tjeter në Komision, kërkijnë térheqjen e atyre komenteve në formë të amendamenteve që i kanë dhënë e tjera, e tjera. Pra e kanë komplikuar punën shumë para komisioneve. Prandaj, ne kur kemi shqyrtuar këto i kemi refuzuar komentet e UNMIK-ut që janë ardhur me vonesë dhe jemi pajtuar plotësisht me mendimet dhe vlerësimet e të gjitha komisioneve, katra të cilat u cekën këtu, që është edhe vendim i sotit. Por unë po e lexoj vetëm një nga komentet, ja këto janë të Komisionit, projektligji këtu që nuk ka qenë e lehtë. Do të thotë, në komentet e UNMIK-ut, që RFJ të mos llogaritet si shtet i huaj apo si territor i huaj, çdo dokument, kjo e ka mundu. Del pastaj Qeveria me komentet e veta, po ashtu në një numër të madh këtu në këtë material dhe po ashtu është një mish-mash tjeter i cili nuk ka dhënë sqarime, prandaj ne këto i kemi refuzuar dhe tash së fundi, do të thotë, vjen versioni i ri, këtë që e tha zoti Hakiu dhe plotësisht pajtohem, dhe unë e pata qëllimin këtu do të thotë, te kjo sepse është bërë një lloj praktike, do të thotë po praktikohet kjo nga Kryesia dhe kërkoi që herave tjera të ndërpritet kjo farë ecurie që po e pengon dhe drejtëpërdrejt pra përgjegjësia shkon këtu. Prej përgatitjes së Projektligjit, në procedim në komisione e deri këtu, po ta

përcjellim punën çka është bërë lidhur me këtë projektligj, vërtet është për çdo përgjegjësi. Prandaj, kërkoi që herave tjera duhet kjo praktikë të ndërpitet, në radhë të parë nga Qeveria, për arsy se nuk mundet Qeveria të nesërmen me dalë me 50, 60, 70 amendamente, sot e enje e të premtën me dalë me do të tjera. I harron ato, pas një jave del me të tjera dhe sot i kemi edhe një palë të tjera. Pra, vështirë është, do të thotë, me e përfunduar, me nxjerrë një rezyme dhe me dhënë përfundimin e drejtë. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Zoti Sadudin Berisha, në emër të Komisionit për komunitete.

### **SADUDIN BERISHA:**

I nderuari kryetar, ministra të respektuar, zonja dhe zotërinjë, Pas miratimit në parim të Projektligjit mbi aktivitetin për tregti të jashtme që është bërë, në seancën e rregullt të këtij Kuvendi, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka marrë në diskutim dhe ka mbështetur një Projektligj të tillë me disa nga vërejtjet të cilat i ka bërë me datën 6 nëntor të këtij viti, kështu që aty janë përcjellur çdonjëri prej deputetëve dhe Kryesisë së Kuvendit të Kosovës duke u mbështetur të gjitha amendamentet mbi plotësimin dhe ndryshimin e këtij projektligji që vjen nga dy komisionet kryesore: Komisioni për buxhet dhe Komisioni për tregti e industri. Sot serish është takuar, ka shqyrtaur të njëjtat propozime dhe i ka rikonfirmuar qëndrimet e saja të nxjerrura më 6.11. duke propozuar ndryshime dhe plotësime konkrete me mbështetjen e serishme të propozimeve eventuale që mund të vijnë nga dy komisionet e Kuvendit, atij për buxhet dhe Komisionit për tregti dhe industri. Dhe, është kërkesë e gjithë neve që amendamentet, pas miratimit të parë të çdonjërit prej projektligjeve, të vjen nga mekanizmat legalë dhe të mbështeten proceduralisht të gjitha procedurat që kërkon miratimi i një ligji nga ky Kuvend. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit zoti Berisha. Do të thotë të tre komisionet që e kanë pasë për detyrë shqyrtimin pajtohen me një që çdo sygjerim i tyre është i amendamentuar dhe duhet të procedojmë. Në ndërkohë, fjalën e ka kërkuar zoti Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë. Urdhëroni.

### **HYDAJET HYSENI:**

Zoti kryetar, zonja e zotrinjë deputetë, Jemi ballafaquar edhe me këtë rast me shkelje të shumta procedurale. Unë do t'i shquaj vetëm disa, duke përsëritur ndoshta ndonjëren prej atyre që u thanë. Së pari, edhe për mua është befasi që sot na shpërndahen amendamente nga Sekretariati i Kuvendit. Nuk jemi marrë vesh kështu. Së dyti, amendamentet shpërndahen sot dhe duhet të shqyrtohen sot! Unë dëgjova vërejtje nga deputetët – si t'i shqyrtojmë amendamentet të

cilat në këtë formë i kemi marrë që sot? Është po ashtu në kundërshtim me rregulla të procedurës. Tre, në tekstin që e kemi marrë, lexojeni me vëmendje ju lutem, në fillim. Nuk do ta dini fare se për cilin ligj është fjala. Tek më vonë do të kuptohet nga përbajtja se është fjala për Ligjin për tregtinë e jashtme, e tjera. Së katërti, ajo që u theksua me të drejtë këtu, na janë shpërndarë tekste me amendamentet e Zyrës ligjore të UNMIK-ut. E kam fjalën thjesht nga ana procedurale - amendamente të cilat edhe nuk janë, mesa mua më kujtohet, nuk na janë proceduar si amendamente, por si komente. Shtrohet puna – si janë bërë tash amendamente të Zyrës ligjore të UNMIK-ut. Zyra ligjore e UNMIK-ut nuk është subjekt ligjvënës, si të thuash i procedurës ligjvënëse në Kuvendin tonë. Ajo ka format e veta specifike për të ndikuar dhe kërkush nuk i mohon ato, por që të procedohet tanë me amendamente të rregullta këtu, siç po bëhet, është në kundërshtim me rregullat e procedurës. Rregulla 30 përcakton shprehimisht se cilët janë ato subjekte që mund të procedojnë amendamente.

Përfundimisht unë propozoj, dhe kjo ishte arsyaja pse unë dola në foltore, që ne të shqyrtojmë sot sipas Rregullores sonë amendamentet e aprovuara nga komisionet që janë të autorizuara për të bërë amendamente. Nëse ka çështje tjera për procedim të mëtejshëm është mundësia që kjo të bëhet në shqyrtimin e tretë. Edhe Qeveria e ka të drejtën që të bëjë amendamente plotësuese dhe, këtë askush nuk e mohon dhe nuk duhet edhe ta mohojë. Ajo pastaj ka të drejtë të shfrytëzojë shërbimet edhe nga të gjithë të interesuarit, edhe nga Zyra ligjore e UNMIK-ut dhe kjo të bëhet në procedurën e mëtejshme. Do të thotë që ne t'i aprovojmë sot, nëse jemi të mendimit, amendamentet e përgatitura në mënyrë të rregullt nga komisionet, por Ligjin si tërsi, ta lëmë edhe për një shqyrtim të tretë, pasi të inkorporohen, e ne nuk e kemi praktikuar asnjëherë këtë, amendamentet në tekstin e spastruar dhe të kompletuar e pastaj si i tillë dhe formalisht komplet të procedohet dhe të aprovohet në Kuvend. Ky është propozimi im. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju lutem, unë isha shumë-shumë i qartë. Tri komisionet që e kanë patur për detyrë e kanë kryer punën përfundimisht. Amendamentet i kemi dhe të shkojmë sipas anës procedurale që është në rregull dhe në fund edhe ju e thatë. Asnjë shqyrtim të tretë, të katërt a të pestë se ne do të donim ballkanasit edhe të tridhjetën ta bëjmë. Në qoftë se arritmë me i shqyrtuar këto sot e aprovojmë punën e në qoftë se nuk arritmë e vazhdojmë të premtën ose të shtunën apo kur të ketë nevojë seancën. Prandaj, vazhdojmë me punë normale, ju lutem. Sa po diskutojmë, vazhdimi po largohemi nga tema.

Është çështja se ka ardhur një amendament në nenin 1, në preambulë, paragrafi... E keni, unë nuk po e lexoj. Do të shkojmë menjëherë sepse këto janë tekste të harmonizuara, do të thotë këtë ndryshim e kanë përkrahur të tri komisionet.

Kush është për këtë amendament, i lutem le ta çojë dorën.

Një, Preamble, paragrafi i dytë... Këto materiale që i kemi aprovuar Fatmir, edhe nga komisionet edhe nga ne. Urdhëro, pasi je jurist zoti Dugolli.

### **BUJAR DUGOLLI:**

Unë do ta tregoj një qëndrim tonin. Ne nuk votojmë për amendamente që kanë ardhur nga Zyra ligjore e UNMIK-ut pa kaluar nëpër komisione, ose pa u deklaruar kryetarët e komisioneve lidhur me ato amendamente. Ne nuk dijmë se a ka kaluar, a është i pranuar dhe a është i harmonizuar. Prandaj, mos na shtini të votojmë për amendamente që kanë ardhur nga Zyra ligjore dhe Zyra e kryeministrat pa kaluar nëpër komisione. Në rast se kanë kaluar, kryetarët e komisioneve le të dalin të tregojnë – ka kaluar dhe ne të votojmë. Përmdryshe, unë s'di se si do të votojmë kështu.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Unë mendoj që sqarimi është i nevojshëm. Amendamentet që i kemi këtu nuk janë amendamente të askujt pos të Qeverisë dhe të komisioneve të autorizuara, sepse i ka harmonizuar Qeveria dhe kanë ardhë. Unë pyes komisionet a janë për këtë, e nëse s'janë nuk i votojmë.

Domethënë, pyes secilin udhëheqës të komisionit për:

Nën 1 që e keni, në amendamentet prej të parit.

Lus Komisionin për buxhet, a e përkrah këtë? - Jo.Komisioni funksional? – Jo.Komisioni i komuniteteve? – Jo.

Prandaj, nuk e përkrah askush dhe hudhet. Do të thotë mbetet ajo siç është në versionin që është aprovuar në Parlament, në shqyrtimin e parë.

Nën 2. Neni 1.2. Sygjerim nga Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve. – Po.

A kemi nevojë ta votojmë se ne u pajtuam në parim që t'i mbështesim komisionet? Të tretë janë bashkë, domethënë. Ju falemnderit.

Nën 3. Neni 1.2. Amendament – Zyra ligjore e UNMIK-ut dhe Zyra ligjore e Kryeministrat, bashkërisht.

Komisioni për buxhet? – Jo.Komisioni i komuniteteve? – Jo.I grupit funksional? – Jo.Prandaj hudhet.

Nën 4. Neni 2. paragrafi 4. Amendament nga Zyra ligjore e UNMIK-ut dhe Zyra e kryeministrat.

Komisioni për buxhet? – Jo. I komuniteteve? – Jo.Funksional? – Jo.  
Ju falemnderit. Komisionet unanimisht e kanë hudhur.

Nën 5. Neni 2 paragrafi 5 – Amendament nga zyra ligjore e UNMIK-ut dhe Zyra e kryeministrat.

Tre komisionet? – jo. Ju falemnderit.

Bëhet një ndryshim në renditje, e kam një propozim. Në vend nën 6, duhet të jetë nën 7 dhe e kundërta, 7-tëshi shkon te 6-tëshi. Në faqën e dytë e keni:

Nën 6. Neni 2, paragrafi 7.

Ju lutem Komisioni për buxhet? – Jo.Komisioni për komunitete? – Jo.

Komisioni funksional? – Jo.Falemnderit.

Nën 7. Neni 2, paragrafi 7 – Amendamenti i sygjeruar nga Zyra ligjore e UNMIK-ut dhe e larguar nga Qeveria.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Komisioni funksional? – Jo.

Ju falemnderit. Do të thotë nuk aprovohet.

Nën 8. Neni 2, paragrafi 10 – Sygjerim nga Zyra ligjore e UNMIK-ut dhe Zyra e kryeministrat.

Komisioni funksional? – Jo.

Ju falemnderit, unanimisht refuzohet.

Nën 9. Neni 2, paragrafi 12 – Sygjerim nga zyra ligjore e UNMIK-ut dhe Zyra e kryeministrat.

Buxhetti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Komisioni funksional? – Jo.

Ju falemnderit. Do të thotë nuk aprovohet.

Nën 10. Neni 2, paragrafi 14 – Sygjerim nga Komisioni.

Komisioni funksional? - Po.Komisioni i Buxhetit? - Po. Komunitetet? – Po.

Ju falemnderit. Aprovohet ky amendament.

Prapë ndryshim i renditjes, në vend të 11-shit ndërrohen vendet të 11-shit dhe 12-shit. Shkojmë.

Nën 11. Neni 2, paragrafi 16 – Qeveria propozon që paragrafi ekzistues të zëvendësohet me paragrinë vijim.

Komisini për Buxhet? – Jo.Komisioni i komuniteteve? – Jo.Funksional? – Jo. Hudhet.

Nën 12. Neni 2, paragrafi 16 – Sygjeruar nga UNMIK-u dhe larguar nga Qeverja. Jo. – Jo. – Jo. Nuk aprovohet.

Nën 13. Neni 2, paragrafi 19 – Sygjerim nga Zyra ligjore e UNMIK-ut dhe Zyra e kryeministrat.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Komisioni funksional? – Jo.Ju falemnderit. Do të thotë nuk aprovohet.

Nën 14. Neni 2, paragrafi 22 – Sygjerim nga Zyra ligjore e UNMIK-ut dhe Zyra e kryeministrat.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Funksional? – Jo.Nuk aprovohet.

Nën 15. Neni 2, paragrafi 22 – Sygjerim nga Zyra ligjore e UNMIK-ut dhe Zyra e kryeministrit.

Komisioni për Buxhet? – Jo.Komisioni funksional? – Jo.Komuniteteve? – Jo. Nuk aprovohet.

Nën 16. Neni 2, paragrafi 23. Të zëvendësohet paragrafi ekzistues me paragafin në vijim.

Komisioni për buxhet çfarë mendimi ka? – Jo.Komunitetet? – Jo. Komisioni funksional? – Jo.Falemnderit.

Nën 17. Ndryshim global.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Komisioni funksional? – Jo.Nuk aprovohet.

Nën 18. Neni 2, paragrafi 26.

Buxheti? – Jo. Komunitetet? – Jo.Funksional? – Jo. Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Nën 19. Neni 2, paragrafi 29.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo. Funknsional? – Jo. Ju falemnderit, unanimisht jo.

Nën 20. Neni 2, paragrafi 29.

Buxheti? – Po.Komunitetet? – Po. Funksional? – Po. S'e dëgjova kryetarin? Aprovohet.

Nën 21. Neni 2, paragrafi 32 - Sygjerim nga Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteteve.

Buxheti? – Po.Funksional? – Po. Komunitetet? – Po. Ju falemnderit. Aprovohet.

Nën 22. Neni 3.1. – Sygjerimet nga Komisioni për tregti dhe industri si dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Buxheti? – Po.Komunitetet? – Po. Funksional? – Po. Ju falemnderit. Aprovohet.

Nën 23. Neni 3.2. – Sugjeruar nga Komisioni për tregti dhe industri si dhe Komisioni për financa e ekonomi.

Buxheti? – Po.Komunitetet? – Po.Funksional? – Po.Ju falemnderit. Aprovohet.

Nën 24. Nen i ri: Nenin 4.1.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Komisioni funksional? – Jo.Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Nën 25. Nen i ri: Sygjerim ...

Buxheti, çfarë mendimi ka? – Jo.Komunitetet? – Jo.Komisioni funksional? – Jo. Nuk aprovohet.

Nën 26. Nen i ri.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Komisioni funksional? – Jo.Nuk aprovohet.

Nën 27. Neni 5.2.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Funksional? – Jo.Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Amendamenti me radhë:

Nën 28. Neni 5.3.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Funksional? – Jo.Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Nën 29. Neni 6.2.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Funksional? – Jo.Ju falemnderit, nuk aprovohet.

Nën 30. Neni 6. – Sygjeruar nga Komisioni për Buxhet.

Buxheti? – Po.Komunitetet? – Po.Funksionale? – Po.Ju falemnderit. Aprovohet.

Nën 31. Neni 7.2. Sygjeruar nga Komisioni për Buxhet.

Buxheti? – Po.Komunitetet çfarë mendimi kanë? – Po.Funksionale? – Po. Aprovohet.

Nën 32. Neni 7.3. – Sygjeruar nga Komisioni për Buxhet.

Komunitetet? – Po.Funksional? – Po.Ju falemnderit. Aprovohet.

Nën 33. Neni 8.1.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Funksional? – Jo.Nuk aprovohet.

Nën 34. Neni 9.1.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Funksional? – Jo.Ju falemnderit.Nuk aprovohet.

Nën 35. Neni 10.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Funksional? – Jo.Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Nën 36. Neni 10.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Funksional? – Jo.Të tri komisionet jo. Nuk aprovohet.

Nën 37. Neni 11.

Buxheti? – Jo.Komunitetet? – Jo.Funksional? – Jo.Nuk aprovohet.Në rregull, kjo ka të bëjë me 37-shin.

Nën 38. Neni 12.1.

Buxheti? – Jo. Funksional? – Jo. Komunitetet? – Jo.Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Nën 39. Neni 12.3. Komisini për Buxhet e sygjeron.

A aprovohet nga të tre komisionet? Ju falemnderit. Do të thotë – Po.

Nën 40. Neni 12.4.

Një – jo. Dy – jo. Tre – jo. Do të thotë nuk aprovohet.

Nën 41. 13.1. të zëvendësohet...

Buxheti? – Jo. Komunitetet? – Jo. Funksionale? – Jo. Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Nën 42. Neni 13.2. Sygjeruar nga Komisioni për të drejtat e komuniteteve.

Po. Po. Po. Ju falemnderit. Aprovohet.

Nën 43. Neni 13.3.

Jo. Jo. Jo. Nuk aprovohet.

Nën 44. Neni 14.1.

Buxheti? – Jo. Komunitetet? – Jo. Funksional? – Jo. Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Nën 45.

Komunitetet? – Po. Buxheti? – Po. Funksional? – Po. Ju falemnderit.

Aprovohet.

Nën 46. Neni 16.1.

Buxheti? – Jo. Komunitetet? – Jo. Funksional? – Jo. Ju falemnderit.

Nën 47.

Një – jo. Dy – jo. Tre – jo. Nuk aprovohet.

Nën 48. Neni 21.2.

Të tre komisionet – Jo. Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Nën 49. Neni 23.1.

Një – jo. Dy – jo. Tre – jo. Nuk aprovohet.

Nën 50. Neni 24.1.

Një – jo. Dy – jo. Tre – jo. Nuk aprovohet.

Nën 51. Neni 25.1.

Jo – të tretë. Ju falemnderit. Njëzërit nuk aprovohet.

Nën 52. Neni 26.

Buxheti – Jo. Komunitetet – Jo. Funksional – Jo. Ju falemnderit.

Nën 53. Neni 27. Komisioni për të drejtat e komuniteteve dhe të interesit.

Një – po. Dy – po. Funksionali? – po. Aprovohet amendamenti.

Nën 54. Neni 28.

Buxheti – jo. Komunitetet – jo. Funksionale – jo. Nuk aprovohet.

Nën 55. Neni 31.1.

Një – jo. Dy – jo. Tre – jo. Nuk aprovohet.

Nën 56. Neni 32.

Të tretë – jo. Nuk aprovohet.

Nën 57. Neni 33.1.

Të tretë – jo. Nuk aprovohet.

Nën 58. Neni 33.2.

Të tretë – jo. Nuk aprovohet.

Nën 59. Neni 34.2.

Të tretë – jo. Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Nën 60. Neni 34.3.

Të tretë – jo. Ju falemnderit. Nuk aprovohet.

Nën 61.

Tretë – Po. Ju falemnderit. Aprovohet amendamenti.

Nën 62. Neni 39.

Tretë – Jo. Ju falemnderit.

Nën 63. Neni 46.

Komisioni për komunitete? – Po. Buxheti? – Po. Funksional? – Po. Ju falemnderit. Aprovohet.

Nën 64. Neni 47.

Një – jo. Dy – jo. Tre – jo. Nuk aprovohet.

Nën 65. Kapitulli 8. – Sygjerim ...

Një – jo. Dy – jo. Tre – jo. Nuk aprovohet.

Nën 66. Neni 49.

Tretë jo. Nuk aprovohet.

Nën 67. Neni i sygjeruar.

Tretë – Po. Aprovohet.

Nën 68. Nen i ri. – Sygjerim nga ...

Tretë – jo. Nuk aprovohet.

Nën 69. Neni 50. – Sygjerim...

Tretë – jo. Nuk aprovohet.

Nën 70. Neni 51.

Tretë – Po. Aprovohet.

Nën 71. Neni 52.

Tretë – Jo. Nuk aprovohet.

Nën 72. Neni 52. Komisioni për Buxhet e propozon...

Tretë – Po. Aprovohet.

Nën 73. Neni 52. Komisioni për të drejtat e komuniteteve...

Tretë – Po. Aprovohet.

Nën 74. Neni 52. Komisioni për ekonomi dhe financa....

Tretë – Po. Aprovohet.

Ju falemnderit, deputetë të nderuar për kontribut. Unë mendoj se u shqyrtuan të gjitha amendamentet në procedurë të rregullt që janë formuluar.

Tani ju pyes – Kush është për aprovimin e Ligjit të pranuar në shqyrtimin e parë, të amendamentuar sot. Numëroni votat ju lutem.

Pyes deputetët a ka ndokush kundër? Asnjë.

A abstenon ndokush nga votimi? Një. Hydajet Hyseni abstenon. Ju falemnderit.

---

#### Votimi – Glasanje – Voted:

---

Për – Za – For .....	64
Kundër – Protiv – Against.....	00
Abstenim – Uzdržanah – Abstained.....	01

---

Prandaj, konstatoj se Ligji është aprovuar në Parlament me: 64 vota pro, asnjë kundër dhe me një abstenim. Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Kemi të bëjmë me marrjen e vendimit nga rekomandimi i gjyqtarëve dhe të prokurorëve me propozim që është shtyer nga mbledhja e kaluar. Të gjitha instancat që kanë pasë të bëjnë me këtë e kanë aprovuar atë mendim të deputetëve në Seancën plenare. Në ndërkohë janë bërë konsultime të nevojshme dhe të domosdoshme. Në Kryesi ka qenë kjo çështje. Dje, me kryetarin e Komisiointit përkatës dhe zëvendësin ose kryesorin e kësaj shtylle të UNMIK-ut, më duket se është zëvendësushtrues i Shtajnerit, Kadia, s'e dij mirë si e ka emrin. Përafërsisht jemi të mendimit edhe Kryesia edhe Komisioni që për shkak të nevojave të mëdha të shprehura me anë të kërkesave gojore që kanë ardhur në Parlament nga

gjyqet, nga prokuroritë, për shkak të mungesës së madhe të personelit në këto institucionë, është një propozim unanim që të shkojmë jo me aprovimin e listës në tërësi, por të shkojmë emër për emër, për secilin veç e veç ose, nëse seanca apo Parlamenti përcaktohet, mund t'i ndajmë vetëm personat për të cilët kemi argumentim që nevojitet, dokumentim i mëtejshëm, kompletim i mëtejshëm i dokumentacionit të atyre dhe pjesën tjeter taaprovojmë në tërësi.

Sabile Basha, a doni me diskutuar në parim. Urdhëroni.

### **SABILE BASHA:**

Inderuari kryetar, deputetë të nderuar,  
Duke lexuar memorandumin e brendshëm të UNMIK-ut, të datës 1.11.2002. ajo që më bëri shumë përshtypje ishte pika 3, në të cilën thuhet, citoi: "Duke patur parasysh nevojën urgjente për plotësimin e vendeve, për të cilat Këshilli rekomandon këta kandidatë, do të ishim mirënjohës nëse Kuvendi do të bënte çdo përpjekje për t'ia dorëzuar përgjigjen e tij Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm brenda kohës së parashikuar nga Rregulla 15.2. i Vendimit ekzekutiv, Nr. 2001 fraksion 12, në kllapa për shembull: (brenda 10 ditëve pune) pas marrjes së këtij rekomandimi nga ana juaj." mbylljet citati.

Nga ky pasus del se zgjedhja e gjyqtarëve dhe e prokurorëve është me shumë urgjencë dhe me nguti. Vetëveti shtrohet pyetja – athua është e nevojshme të ngutemi që pas një muaji apo një viti të pendohemi dhe të fillojmë të bëjmë përsëri punën nga zeroja, domethënë në fillim. Dhe, kur qenka puna me aq urgjencë, pse këto dokumente po sillen me aq vonesë. Të nxitojmë ngadalë, thotë një fjalë e urtë, ngase ne shqiptarët në Kosovë fortë mirë e dijmë se çka do të thotë të jeshë gjykatës ose prokuror. Se veprimet e tyre i kemi ndier rënd mbi kurrizin tonë. Mbase jo të gjithë, por sigurisht çdo i dyti prej nesh kemi patur rastin që të na ftojnë për të na denoncuar apo për t'na shqiptuar vite marrëmendëse burgimi. Duke i referuar të kaluarës, propozoj që të mos nxitojmë për t'iu dhënë shansin ricidivëve e të zënë vendet që i kanë përbaltur në një kohë të caktuar dhe tani asesi s'e meritojnë. Andaj, për të vendosur për një gjë aq të rëndësishme nuk duhet ngutur, sidomos ne parlamentarët kur e dijmë që të gjithë se me çfarë disponimi ka hasur tek populli i Kosovës.

Duke i analizuar ato pak të dhëna të kandidatëve ose shënimë biografike, e që përsëri janë të mangëta - shumë të mangëta, sepse në ato shënimë mungon shumë. Bile të ishin ato elementare, siç është datëlindja, vendlindja dhe ku punon apo ku ndodhet tani. Ato na mungojnë, që, për mendimin tim, janë shumë të rëndësishme. Megjithatë, unë bëra një statistikë ku Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë së Kosovës Parlamentit të Kosovës i propozon 42 kandidatë. Këta persona, në bazë të të dhënave, i kam klasifikuar në trë grupe. Në grupin e parë do të hynin të gjithë ata kandidatë që prej ditës së diplomimit e gjer në vitin 1999 kanë patur marrëdhënie pune të pandërpërë në gjykata të ndryshme të Kosovës ose jashtë saj. Prej 42 të propozuarve 18 prej tyre kanë qenë në shërbim të okupuesit. Në grupin e dytë hyjnë të gjithë ata që marrëdhënien e punës në gjyqësi e kanë ndërpërë me 1992 apo ndonjë vit tjeter dhe në gjyqësi nuk

kanë punuar gjer më tanë. Prej tyre janë 9 kandidatë. Në grupin e tretë përfshihen ata kandidatë që gjatë viteve 1990-2000 kanë punuar në sektorë të tjera jashtëgjyqësor ose i takojnë brezit të ri dhe nuk kanë patur shansë të krijojnë marrëdhënie pune. Në këtë grup hyjnë 15 kandidat.

Dhe, krejt në fund, propozoj që të kohen parasysh të gjithë ata kandidatë që kanë qenë në marrëdhënie pune si gjykatës dhe prokurorë gjer në vitin 1999 pa u futur në biografitë në thojza “të pasurat e tyre” kisha propozuar që të refuzohen, ndërsa për grupin e dytë dhe të tretë të bisedohet këtu, meqë edhe ashtu kemi juristë të shumtë, siç e patë cekur në mbledhjen e kaluar Hajredin Kuqi, se kemi mbi 8000 të diplomuar juristë, e që punën në gjykata e prokurori në të ardhmen do ta kryenin me shumë sukses. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Unë do të sygjeroj atë që e kam gjithmonë në strategji, në procedurë dhe në plan. Atëherë kur komisionet përkatëse i harmonizojnë qëndrimet në Parlament nuk ka as dridhje as nuk kalon asgjë e pashqyrtuar mirë. Me këtë rast ju lutem unë do të doja që të rrespektohet ky rregull. Në komisione janë 11 anëtarë, në çdo komision. Në çdo komision janë të gjitha grupacionet relevante politike. Çdo komision ka kohë për të gjitha këto dhe në qoftë se një komision që është shumpartiak, që është edhe shumkombëtar të them, vjen një propozim, ai propozim aprovohet në Kryesi e cila është po ashtu në formacione të të gjitha partive relevante në Parlament dhe në qoftë se nuk ka argumente shtesë është mirë që anëtarët e komisioneve, siç jemi marrë vesh edhe në Kryesi, anëtarët e atyre komisioneve dhe anëtarët e Kryesisë ta përkrahin. Nuk them anblok listën e gjyqtarëve. Unë kam qenë shumë i qartë në propozime. Do të thotë gjithkund dhe gjithmonë atje ku parlamentarët kanë vërejtje të argumentuara shqetësimet e secilit do të merren në konsideratë dhe brenda mundësive t'i aprovojmë. Nuk jemi në kohë kur mundemi anblok, pa dokumentim të mirë t'i kthehem i rishqyrtimit të historisë. Jemi në Parlament. Prandaj, është kërkesë e të gjithë atyre që i ushtrojnë detyrat, jo kërkesë e organeve udhëheqëse, që shumë lëndë, shumëçka e unë besoj se ndokush prej gjykatësve e juristëve këtu mund ta merr... të shkojmë atje ku Parlamenti nuk ka vërejtje dhe të mos i bllokojmë proceset. Atje ku i kemi vërejtjet konkrete, ta shtyjmë, ta heqim thash nga rendi i ditës me kërkesë që të plotësohen informacionet e duhura. Në qoftë se ka nevojë po e qes ... Urdhëro, zoja Nekibe Kelmendi.

### **NEKIBE KELMENDI:**

Inderuari kryetar, kolegë të nderuar.  
Vërtetë kur flitet për gjyqësorin kemi të bëjmë me një segment të shtetit, është prerrogativ i shtetit dhe duhet gjithmonë të jemi të matur se kush do të jetë bartës i funksionit të gjyqtarit e kush jo. Aq sa jemi ne në dijeni dhe aq sa kemi

ne kompetenca çeshtja e gjyqësorit është rezervuar për Përfaqësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Pikërisht ai edhe ka nxjerrë Rregulloren përkitazi me kriteret për emërimin e gjyqtarëve, jo për zgjedhje, për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Kur e them - jo për zgjedhje, do të thotë se nuk zgjedhen por emërohen, kur emërohen do të thotë nuk i emëron Parlamenti por Parlamenti jep një pëlqim vetëm formalo-juridik. Është e vërtetë se është mëse urgjente që gjykatat dhe prokuroritë në përgjithësi gjyqësori i Kosovës të kompletohet me kuadro sepse janë duke punuar me më pak gjyqtarë e prokurorë për 184 sa ka qenë paraparë fillimi i kur është themeluar Departamenti i Drejtësisë, ndërsa më pak për 284 gjyqtarë e prokurorë sa i nevojiten gjyqësisë së Kosovës dhe lëndët, çeshtjet apo dosjet çdo ditë vijnë e grumbullohen dhe mund t'ju them se gati një gjysmëngulfatje në gjakata tani për tani ekziston.

Unë e kam marr listën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të cilët i ka propozuar Këshilli Prokurorialo-Gjyqësor. Të gjithë ne jemi të përcaktuar, e këtë e ka paraparë edhe Rregullorja për emërimin gjyqtarëve dhe të prokurorëve që gjykatat duhet të janë të përbëra ose të janë multietnike siç e parasheh edhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 8. Mirëpo, unë me këtë rast, atë që do ta tha, është: Konsideroj se nuk duhet të jipet pëlqimi për ata gjyqtarë e prokurorë të cilët i kanë injoruar rregulloret dhe dokumentet e UNMIK-ut prej vendosjes së UNMIK-ut në Kosovë e tutje. Kur e them këtë, e kam fjalën për funksionimin e gjykatave paralele të komunave – për kundërvajtje, komunale, të qarkut të cilat disa kanë funksionuar këtu brendapërbrenda territorit të Kosovës kurse disa në Serbi. Bile-bile, ju e dini fare mirë se mbi 2000 veta kanë kaluar nëpër gjykata që janë emërtuar, gjykatat e qarkut të Prishtinës e në fakt ato kanë funksionuar si gjykata paralele nëpër Serbi kurse UNMIK-u i patë themeluar gjykatat e veta këtu dhe e ka pasë plotësuar tërësisht dhe kompletuar rindërtimin e gjyqësorit. Për përfundim prandaj, duke u nisur edhe nga vetë betimi solemn që do ta bëjnë gjyqtarët i cili thotë – solemnisht deklaroj dhe premtoj se do t'i kryejë funksionet që më janë besuar me Rregulloren e UNMIK-ut dhe me udhëzimet administrative të nxjerra në përputhje me të dhe të mos kërkojë apo pranojë udhëzime nga çfarëdo burimi tjeter, për mendimin tim të gjithë gjykatësit që kanë gjykuar në gjykatat paralele pas vendosjes së UNMIK-ut nuk duhet të emërohen tani për gjyqtarë. Më vjen fare keq që prej këtij komisioni si duket jam vetëm unë e pranishme, që do të thotë se duhet ta kapi vetëm unë gështenjën e nxehtë nga zjarri dhe të diskutoj për këtë problem, por unë po e shprehu tash për tash mendimin tim personal si deputete e këtij Kuvendi.

Kam një sygjerim edhe për Kryesinë e Kuvendit që t'i drejtohet me një shkresë, Këshillit Prokurorial Gjyqësor që të mos limitojë në 65 vjet moshe për gjykatësit e Gjykatës Supreme funksionimin e tyre si gjykatës e prokurorë për mungesë të kuadrove. Sepse, edhe ashtu Gjykatës Supreme të Kosovës i mungojnë 16 gjyqtarë. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Unë mendoj se kjo e fundit është e rëndësisë që duhet t'i drejtohem, do të thotë që pajtohemi të gjithjë, ndërsa ... Urdhëro Hydajet.

## **HYDAJET HYSENI:**

I nderuar zoti kryetar, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, Unë prap me çështje procedurale dhe mendoj një çështje parimore. Më lejoni ta filloj pikërisht me çështje të tilla. Është bërë sikur një modë që ne të përkujdesemi për ato që quhen kompetenca të rezervuara. Ka kush kujdeset për to, ju lutem. Ne le të kujdesemi për kompetencat tona për të cilat edhe e kemi mandatin këtu. Aq më tepër nëse lejojmë interpretime të pasakta edhe të dispozitave me të cilat punojmë. Unë do të jam i detyruar për herë të dytë t'i referohem Kornizës kushtetuese e cila shprehimisht thotë: Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes kanë përgjegjësi të mëposhtme në fushën e çështjeve juridike të marrin vendime – vendime – sa i përket emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve; b) të ushtrojnë përgjegjësi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e rregullt të gjykatave brenda strukturave ekzistuese të gjykatave; të sigurojnë, zhvillojnë, dhe mirëmbajnë shërbimet e gjykatave dhe prokurorisë, e të tjera në këtë frysë. Nëse të tjerët me arsyesh apo pa arsyesh na ngushtojnë fushëveprimin, mos ta ngushtojmë vetë, ju lutem. Të kthehem te ajo që ne kemi pasur prej fillimit si vërejtje, si kontest. Është kërkuar nga kjo tribunë, nga Kuvendi, është kërkuar nga komisionet, është kërkuar edhe nga Kryesia informatë e plotë dhe kjo informatë e plotë nuk na ka ardhur, kurgjë nuk ka ndryshuar nga dokumentacioni që kemi pasur që në fillim. Dhe tani ne jemi në situatë të pamudshme siç ishim pak më parë. Ose të vendosim diçka bjanko, pa e ditur çka po vendosim ose të ballafaqohemi me sfidën tjetër ta zvarritsim dhe asnjëri nuk do ta dëshirojë këtë. Ne kemi kërkuar që të dijmë së paku ku jetojnë këta që janë propozuar. Të dijmë datëlindjen, siç u tha, çfarë moshe kanë. Është kërkuar edhe nga Komisioni, po tërheq vërejtjen, legjislativ të kemi në dispozicion edhe listën e kandidatëve, të dijmë kush është refuzuar. Unë dij, për shembull raste, që s'po dua t'i përmend këtu, kur është refuzuar njeriu që ka qenë i dënuar në procese të montuara edhe pse i ka plotësuar kushtet, kurse zgjedhen ata që i kanë dënuar njerëzit e pafajshëm. Dikush mund të thotë po kthehem i në të kaluarën. Jo, zonja e zotërinj. Por nuk është fjala për shkelje politike. Le t'i shikojmë ato në vende tjera, por është fjala për shkelje procedurale, për shkalje profesionale. Ata që kanë shkelur ligjin dhe kanë gjykuar në bazë të instruksioneve të komiteteve, nuk e kanë të drejtën morale që përsëri të kërkojnë që të ushtrojnë të njëtin funksion, sepse e kanë shkelë profesionin e tyre. Ne po kërkojmë ndonjëherë që të na kërkohet falje, po kërkojmë prej atyre që janë jashtë Kosovës të kërkojmë falje. A e kanë një obligim edhe ata që kanë pre vite e vite burgje, kanë përjashtuar me mijëra e mijëra njerëz nga puna, nga banesat, nga të drejtat e tyre elementare që edhe ata të bëjnë diçka në funksion të pajtimit e të tejkalimit të asaj praktike të ndryshkur që ka qenë. Prandaj, nëse kërkojmë rrespektim të procedurës, me rregulloren me të cilën është formuar ky Këshill Gjyqësor e Prokurorial edhe shprehimisht thuhet dhe ju keni parë është botuar këto ditë edhe një konkurs në të cilin përjashtohen ata që kanë lejuar praktika diskriminuese ose që janë përfshirë në praktika diskriminuese. Dhe nëse ne kërkojmë këtë, kërkojmë diçka që është edhe në përpunje me Rregulloren e UNMIK-ut. Po ka diçka me të cilën ne nuk mund të pajtohem. Në këtë rregullore kërkohet që për gjykatësin apo prokurorin të ketë 7 vjet përvojë pune. Ju

i dini kush ka pasur mundësi të ketë 7 vjet përvojë pune në gjykatat dhe prokuroritë tona. Dhe a është kjo e domosdoshme në specifikat kosovare? Prandaj, që të mos lejojmë ne përsëri që ata që janë emëruar nga komitetet dhe nga shtabet politike antikosovare tani të vijnë përsëri në ato funksione tepër të ndjeshme me votën tonë – unë propozoj që Kuvendi të mos e aprovojë listën si totale, si tërësi, por të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor e Prokurorial që të rrespektojë procedurat dhe ta informojë Kuvendin siç dihet me të gjitha të dhënat që janë kërkuar: një – datëlindjet; dy – ku jetojnë; tre – përvoja e tyre, do të thotë ku kanë punuar e tjera dhe katër – lista e kandidatëve të refuzuar sepse vetëm në atë mënyrë ne mund të bëjmë krahasimin dhe të dijmë se është vendosur drejt apo nuk është vendosur drejt. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Urdhëroni. Ramadan Kelmendi.

### **RAMADAN KELMENDI:**

Inderuari kryetar, të nderuar deputetë,  
Duke marrë në shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës, unë personalisht ndiej përgjegjësi morale dhe njerëzore që të flas edhe me emra e me mbiemra dhe konkretisht për kandidatët e jo në mënyrë të përgjithësuar pasi që vij nga një qytet ku kandidatët e propozuar...

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju lutem do të hyjmë në krizë të kuorumit. Mos e lëshoni seancën, nuk do të zgjasë shumë.

### **RAMADAN KELMENDI:**

... dhe mendoj se në mbledhjen paraprake është kërkuar të jipet biografia dhe puna e secilit kandidat të propozuar. Personalisht prap mendoj se nuk është kryer ky obligim dhe me biografinë që kemi, përgjithësisht nuk kemi të drejtë morale të dhëmë bile pëlqimin sepse u kuptua këtë ne nuk i zgjedhim por emërohen dhe dhëmë një pëlqim përmes emërim. Unë ju them se në këtë listë kemi kandidat që nuk e ka provimin e jurisprudencës, nuk ka asnjë vit përvojë pune, jeton në Prishtinë dhe është propozuar në vend të kandidatit në Mitrovicë që jeton e punon 3 vjet në gjykatë atje, e kandidati nga Prishtina. Rasti i dytë, të gjithë kandidatët e propozuar në gjykatën komunale janë jashtë sistemit të UNMIK-ut dhe janë pjesëtarë të minoritetit serb. Kemi kandidat që ka diplomën, ka përvojën e punës, ka provimin e jurisprudencës, ka punuar në komisionin përmes zbulimin e krimeve të luftës në Kosovë, ka paraqitur 220 lëndë dhe dorëzue Tribunalit të Hagës e të gjitha dhe as që është marrë në propozim. Dhe, rasti konkret, Mehmed Xhekoviq ka punuar në "Jugo-bankë" nën masat e dhunshme të pushtetit serb, ka denoncuar dhe ka diferencuar shqiptarët, i ka tri kombësi, tri përkatësi kombëtare, sipas ndërrimeve politike: e para, deri në 80-tën ka qenë shqiptar, prej 81-shtë e këndej është deklaruar si turk dhe tani si boshnjak. Unë dëshiroj që në biografinë e tij të

shënohet si është dhe ta ngris gishtin. E dyta, Jelena Krivokapiq ka punuar në "Trepçakomerc", ka marrë pjesë në diferencimin e shqiptarëve, pastaj ka kaluar në gjykatë në Mitrovicë, edhe sot nuk e njeh gjykatën e UNMIK-ut e as gjykatat e rregullta, me një aktvendim, aktgjykim të saj ka larguar të drejtën e mbrojtjes së punës së shqiptarëve, 60.860 kërkesa të shqiptarëve për t'u kthyer në punë, për t'i mbrojt të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe sot na propozohet. Pastaj Zahra Vërbovci, është në marrëdhënie familjare të ngushtë me Mehmedoviqin dhe kurrë nuk ka punuar në gjykatë, për tre muajt e fundit është në gjykatën për kundërvajtje dhe avancohet në gjykatën komunale. Dhe, rasti i fundit, Jusuf Berisha, ka vetëm fakultetin juridik. Në vend që të propozohet kandidati Naim Beka është propozuar ky nga Prishtina dhe ku deklarohet me plotë të drejtë, njerëzit që më kanë thënë dhe ata mund të dëshmojnë mbi bazat të cilat ata i dijnë, flitet edhe për korruption. Të gjitha këto janë vështirë për t'i thënë por duhet t'i themi dhe në fund, në vend të Zahrës, punon Xhevdet Abazi me të gjitha paradispozitat që i takojnë një epiteti të gjyqtarit dhe as që është përcaktuar. Unë kam edhe të dhëna tjera, por nuk dua t'i elaboroj më tepër, flas vetëm për Mitrovicën dhe të gjitha këto qëndrojnë e edhe unë qëndroj prapa tyre me të gjithë dëshmitarët që mund të dëshmojnë para çdo komisioni. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Zoti Dugolli.

### **BUJAR DUGOLLI:**

Me një letër që ia ka dërguar Përfaqësuesi Special Kuvendit ka përshëndetur punën dhe si e kemi trajtuar ne këtë çështje për t'i dhënë rekomandimet tona si Kuvend dhe mendoj se ajo kërkesë që ishte për shtyrje deri të marrim informacione të duhura ka qenë e drejtë. Ndërkohë, ne kemi pritur kur kemi hapur kutitë tona, kemi pritur se kur do t'i gjejmë biografitë e këtyre gjyqtarëve dhe ato nuk na kanë ardhur. Mendoj se është një problem që kemi në mes Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës. Unë mendoj se ne nuk mund të vendosim kështu. Komisioni përkatës më 12.11. i ka dhënë disa rekomandime. Kur ka filluar debati është tërhequr prej atyre rekomandimeve, ndërsa në mbledhjen më 25.11. na dërgon një letër me disa konkluzione. Unë mendoj se pasi fshihen biografitë nga Këshilli Prokurorial Gjyqësor që nuk ia dërgon Kuvendit si duhet, prapa këtyre njerëzve fshihet diçka tjetër. Fshihet ajo që po e kontestojnë edhe deputetët tjerë. Mendoj se as në këtë seancë ne nuk mund të votojmë dhe unë personalisht nuk do të votoj për asnjë nga këta pa e pasur biografinë e cila është verifikuar nga komisioni përkatës dhe pasi të marrim rekomandimin me një biografi të verifikuar anga komisioni përkatës atëherë ne do të jemi në gjendje të votojmë për ta. Unë personalisht nuk mund të votoj për këta pasi që s'kemi kurrfarë propozimi të qartë nga komisioni përkatës i Kuvendit dhe kërkoi që në këtë periudhë, pas kësaj mbledhjeje, komisioni në rast se është i blokuar nga Këshilli Prokurorial Gjyqësor t'i ftojë kandidatët e apostrofuar dhe t'i dërgojnë biografitë pranë komisionit

përkatës të Kuvendit dhe ne t'i shqyrtojmë e t'i dhëmë propozimet për ta e mos t'ia vështirësojmë punën veti. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Të falemnderit. Zoti Muhamet Kelmendi.

### **MUHAMET KELMENDI:**

Gjatë diskutimit lidhur me propozimin e bërë nga komisioni ose këshilli prokurorial ne kemi patur edhe në Komisionin për çështje juridike-legislative, është fjala kur është dhënë rekomandimi ose edhe jorekomandimi i tillë, e kemi patur aty prezent edhe kryetarin e Komisionit. E shoh tash të arsyeshme t'i informoj deputetët dhe ju zoti kryetar i Kuvendit se ai kolegjum që paraprakisht ka shqyrtuar këtë dhe kryetari ka deklaruar se ka të gjitha informacionet në tërësi lidhur me të gjithë kandidatët qoftë të rekomanduar qoftë të refuzuar, qoftë të atyre që u janë kërkuar informacione se ku kanë punuar, ku jetojnë aktualisht, çfarë kualifikimi shkollor kanë, çfarë veprimtarie kanë kryer deri më 1999 dhe pas 99-tës ku kanë punuar, a kanë punuar në gjykatat paralele, për çka zonja Kelmendi shumë drejt e shprehi në pikëpamjen e saj lidhur me këtë çështje. Unë edhe një herë ju them, e kështu kam thënë edhe në seancën e kaluar, se duhet të kemi informacione të plota. Këshilli Prokurorial i ka të gjitha informacionet, për çdonjërin veç e veç, i ka edhe deklaratat e marra, prandaj nuk është një informacion i plotë e as i përafërt dhe as 10% mund të themi për të konstatuar një qëndrim tonin se a duhet të shkojmë sot në votimin e tyre apo jo. Mendoj se duhet t'i jipet fund kësaj praktike dhe njëherë e përgjithmonë të kuptohet se pa informacione të detajizuara lidhur me dy çështje kryesore: veprimtarinë deri në 99-tën dhe së dyti pas 99-tës lidhur me punën se ku kanë punuar, në cilat segmente dhe instrumente kanë punuar për gjykata paralele apo jo dhe në bazë të këtyre pastaj ne të procedurojmë më tutje, në mënyrë që të jemi në gjendje së deputetë për ta dhënë votën tonë për çdo rekomandim që jipet. Këtë e kam thënë edhe në Komision dhe në Komision kemi votuar një për një dhe natyrisht kam votuar kundër të gjithë këtyre kandidatëve jo pse kam dëshirë ose ta pengoj sistemin e tillë të vendimit të gjyqësisë në Kosovë, përkundrazi, e dij siç thotë një fjalë e popullit, në perëndim atje, derisa mjeku e shëron një pacient i cili është i sëmurë prej një sëmundje gjykatat dhe organet tjera të drejtësisë e kanë për qëllim me shëruar një shoqëri. Por nuk shërohet shoqëria jonë kosovare me njerëz të cilët i kanë shërbyer regjimit të Millosheviqit me vite të tëra këtu. Nuk mund ta shërojmë dhe është e pamundur të ecim përparrës në këtë drejtim. Dhe, në qoftë se ndokush mendon se nuk është vendi në Kuvend për të diskutuar për të kaluarën unë nuk dij atëherë ku është vendi. Në Qeveri s'qenka vendi, nëpër institucione të ndryshme s'qenka vendi dhe unë mendoj se është pikërisht Kuvendi ku duhet të diskutojmë për të kaluarën, sepse këtu janë përfaqësuesit e popullit, kemi dalë nga vota e popullit dhe natyrisht ne jemi ata të cilët duhet të themi fjalën për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Zoti Berat Luzha, urdhëron Berat.

### **BERAT LUZHA:**

Të nderuar deputetë,

Këtu u tha se Kuvendi duhet të japë vetëm një pëlqim formal. Unë mendoj që Kuvendi nuk duhet të japë pëlqime formale për shkak se në këtë mënyrë e diskualifikon vetëveten dhe Kuvendi nuk është organ që bën pëlqime formale.

Në konkluzionet e Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë kushtetuese, pika 4, thuhet se i rekomandon Kuvendit që gjersa të mos plotësohen kërkesat që i bën Komisioni në tri pikat e para, të shtyhet vendosja meritore lidhur me këta kandidatë.

Dhe, pika 3. Unë mendoj që duhet të shikohet edhe përbërja e Këshillit Gjyqësor Prokurorial i cili i ka futur në lista edhe personat, siç përmendi deputeti Ramadan Kelmendi, të cilët e ndërrojnë kombësinë sipas politikës, ndërrojnë edhe çdogjë, edhe ata që kanë dënuar, kanë nënshkruar vendime për dënimë politike. Unë jam në dijeni se kryetari i këtij Këshilli është personi nënshkrimi i të cilit gjendet në dhjetëra e në qindra aktvendime politike për propagandë armiqësore e tjera, e tjera. Falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Të falemnderit. Zoti Hilmo Kandić.

### **HILMO KANDIĆ:**

Hvala gospodine predsedničë. Gospodine predsedničë, poštovani kolege, Ja sam se javio za reč, isto kāo i moji prethodnici, jer sam imao povodom ove tačke dnevnog reda da i ja kažem nekoliko riječi. Ono prvo što hoću da kažem je da se pridružujem onima koji su kazali da neću danas glasati za ovu preporuku iz nekoliko razloga. Prvi je razlog, dakle onaj kao što je neko ovde primjetio da uglavnom obično oni ljudi, a nažalost, njih nije bilo malo, o kojima je uvjijek bio taman svakako u dijelu, prije svega u prošlosti ti su ljudi kod medjunarodne zajednice i danas prihvatljivi za njih, i onda dodjemo u situaciji da se mi pitamo jednostavno zašto smo se žrtvovali i mi kao individua i jednostavno i svoju porodicu i svoju zajednicu. Samo da kažem, nije prvi slučaj samo sa ovijem što je gospodin, dakle moj kolega kazao, za Muhameda Džekovića, dakle koji se prije izjašnjavao kao Albanac, zatim kao Turčin i danas kao Bošnjak. Mi imamo i danas, nažalost, u više institucija gde na mestu Bošnjaka se nalaze predstavnici drugih zajednica. Medjutim, ono što hoću da kažem, dakle nažalost, ponavlja se i prošlo, i prije ovoga danas o čemu razgovaramo, da se griješi u mnogome.

Na žalost u svemu ovome grieše ljudi koji su odgovorni, dakle predstavnici medjunarodne zajednice ali ja bih zamolio ovde poštovani kolege vas da vi ne griešite ovde. Mi znamo prije svega koliko je koje zajednice bilo na Kosovu do izbijanja agresije. Znamo koliko ih ima i sada. Niko od nas ovdje, ja sam siguran, nema protiv, ni protiv koga, niti protiv koje zajednice, dakle nacije, prije svega ne protiv poštenih ljudi, ali imamo protiv onih sigurno koji su kumovali i stradanju, i teroru, i svemu onome što se dešavalo na Kosovu i koji danas jednostavno veoma organizovano iz centra odakle dolaze blokiraju se naše institucije. Dakle, radi se o tome da na ovom listu, dakle ove preporuke za imenovanja sudija ili tužilaca ima 14 Srba, dakle u pitanju je samo jedan takozvani Bošnjak. Dakle to je odnos 14 prema 1. Nažalost znači 14 prema 0. Ja vjerujem da se slažemo, ili 15 prema 0, dobro ste rekli. Dakle u pitanju je jedna preporuka dakle koju treba cjeniti i po meni na razmatranje prije svega dok se posebno od svih pojedinaca dakle ljudi koji su imenovani za ove funkcije jer se radi o veoma osetljivim funkcijama, ljudi koji sigurno nijesu mnogo od njih zaboravili način ponašanja prije kada su radili, dakle sa punim podacima i jednostavno prije svega biografijom svih ljudi i to da budu dostavljeni ovdje u Parlamentu, dakle u Skupštini gde bi bili nama na dohvatu. Eto, toliko. Hvala najlepše.

#### KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit zoti Kandiq.

Unë mendoj se është koha të përfundojmë. Nga debati i shumëlojshëm nga dy grupe parlamentare të deklaruara dhe nga të gjitha diskutimet del një emërues i përbashkët që dokumentacion valid për të vendosur sot nuk kemi. Dhe unë mendoj se duhet të shkojmë me një konkluzion të cilin duhet ta votojmë dhe që komisioni përkatës nga instanca që i është drejtuar të kërkohen të gjitha ato informacione që janë parashtruar në seancë plenare. Në qoftë se zoti Kurteshi keni jashtë kësaj diçka të veçantë ose zoti Çelaj, mund të debatojmë. Nëse jeni brenda këtij mendimi, megjithatë ju vlerësojeni... Urdhëroni.

#### ISMAJL KURTESHI:

Zoti kryetar, deputetë të nderuar,  
Konsideroj se tendencia për tâ instrumentalizuar këtë Kuvend po intensifikohet. Ky Kuvend shumëshpesh sillet para akteve të kryera ku duhet të vendosë për çështje për të cilat i mungojnë informatat e duhura ose ato i merr në prak të mbledhjeve siç ndodhi sot me materialin për pikën e mëhershme për Ligjin për tregti ose për materialin të cilin ne tani e kemi në dorë për gjykatësit edhe pse kemi kërkuar informata të duhurâ dhe në emër të ngutisë ose të nevojës kërkohet nga ne që të votojmë për ata që nuk e dijmë se a e meritojnë apo nuk e meritojnë të votohen dhe në këtë formë ne mund ta bëjmë një gabim jashtzakonisht të madh e ajo është ta legjitimojmë një regjim represiv i cili është mbajt në jetë nga njerëz të tillë të papërgjegjshëm. Prandaj, nuk mjafton që të kemi vetëm informata për këta njerëz, por duhet t'i kemi informatat edhe për njerëzit të cilët janë refuzuar dhe të njoftohemi për krejt punën e atyre komisioneve të autorizuara që të refuzojnë apo ta propozojnë ndonjërin pasi që përveç tjerash thuhet se kandidatët që propozohen mund të bëhen gjykatës nëse e pranojnë detyrën. Do të thotë se as njerëzit

të cilët janë propozuar nuk janë konsultuar dhe kjo krejt ngjet me një punë joserioze dhe neve këtu na merr kohë.

Edhe një çështje dëshiroj ta them. Konsideroj se edhe shumë deputetëve këtu, propozimet e deputetëve injorohen nga ju zoti kryetar. Sot në këtë Kuvend janë propozuar pika për mua shumë të rëndësishme, siç është çështja e diskutimit rrëth monitorimit të Kuvendit, çështja e diskutimit rrëth plagosjes së një vajze, pra cenimit të territorit të Kosovës dhe njerëzve të saj në Kosovë dhe çështja e grevës së studentëve të cilat ju, pa e marrë mendimin e këtij Kuvendi, i injoruat dhe kjo nuk është hera e parë. Mendoj se është koha e fundit ta kuptioni se ju jeni njeriu i barabart, i pari ndër të barabartit por ju nuk jeni Kuvendi vetë dhe ju kisha lultur që herave tjera të keni konsideratë më të madhe ndaj propozimeve të deputetëve. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Lirak Çelaj.

#### **LIRAK ÇELAJ:**

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë,  
Unë po them se pajtohem me të gjitha këto vendime që do t'i marrim ne sot e që i propozuat ju kryetar. Mirëpo prap edhe biografitë që do të na sillen nga ai këshill, unë për veti nuk mund t'iu besoj sepse në qoftë se ata njerëz na e kanë propozuar një listë të tillë ata prapë mund t'na i biejnë falls dhe s'e di si është mekanizmi që t'u besojmë këtyre biografive. Çka do të thotë vendlindja, banimi ose nëse ka punuar deri më 99-tën ose deri më 90-tën? Nuk do të thotë se ai që ka punuar deri në 90-tën është më burrë i mirë se ai tjetri atje, sepse e dijmë që ka shpesh shumë raste që avokatët kanë dalë me avokaturë nga gjyqësia dhe në marrëveshje me atë sistem kanë punuar e bashkëpunuar bashkë. Prandaj, kërkoj që ne t'i shpallim këta emra publikisht, t'i bëjmë publikë e qytetarët dhe të gjithë ata njerëz të cilët kanë vërejtje konkrete për këta njerëz t'i dorëzojnë në komisionet që kemi këtu brenda Parlamentit dhe ato pastaj t'i shqyrtojnë dhe t'i kompletojnë këto informata. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DÄCI:**

Ju falemnderit. Urdhëro zoti Sadik.

#### **SADIK IDRIZI:**

Muslim da ovaj posao ne možemo nikad završiti ako ne krenemo konkretно. Uvek është primedbi na odredjene ljudë iz odredjenih sredina. Prvo, ona primedba koja se odnosi na one koji su radili u period 90-99-ta godina može da bude kao argumenat ali pojavice se novi argumenti pa është neke druge prirode argumenti, argumenti konkurencije, argumenti iz neke sredine pa rečiçe taj... ja sam isto konkurisao pa me nisu primili, primili su.... Ovi koji su radili, znaçti ta komisija odnosno Sudsko veće, on

je imalo neke kriterijume. Drugo, ovde što se javlja veći broj Srba, verovatno da nisu u dovoljnoj meri zastupljeni u sudovima ili njihovi sudovi na njihovoj teritoriji do sada nisu radili pod kompetencijom UNMIK-a odnosno naših vlasti sa Kosova. Drugo je

pitanje, ako neko ima zaista tačnih podataka za odredjenu osobu da se odstrani i da ostane za određeno vreme ali ima ljudi koji zaista treba da prodju ovde i u ovu Skupštinsku proceduru i da budu izabrani za sudiju. Ja sa ove liste koja je ovde data poznajem samo jednoga. Znači, od kompletne liste znam samo jednoga i mogu samo o njemu da govorim. To je kandidat iz Dragaša, za Opštinski sud u Dragašu i kažem da je radio od 90. do 99. godine i čovek koji danas radi i vodi kancelariju lokalnih zajednica u Dragašu i mislim da je čovek koji može da prodje ovu proceduru iz razloga što ćete čuti od Albanaca i od ostalih, znači on je pripadnik Bošnjačke odnosno Goranske zajednice, čućete od Albanaca da u ovom periodu nije bio od onih koji su imali da ne kažem nešto ili neku mrlju u svojoj biografiji. Vi ćete imati od Albanaca sudiju koji nije radio i koji je radio 85. godine doćiće i rećiće a ovaj nije dobar jer me osudio po čistom nekom pravnom pitanju bilo kojem. Ali mi moramo imati ovde danas znači neke stvari, mi možemo ovo odložiti i tražimo opet biografije, opet ćemo imati nekih nedostataka kod određenih biografija. Mislim da moramo ispoštovati ovo sudska veče, u njemu je 10 ljudi, 5 su medjunarodnjaci, 5 su odavde kosovari 4 od njih su Albanci i jedan Srbin mislim i oni su prošli tamo u tom veću. Komisija je morala da ono što je dala, u prvoj verziji na prvom onom prethodnom zasedanju, preporuku i svrstala je u tri kategorije, ona koja je bila znači i tu je opet u Komisiji bilo ljudi koji su mogli da kažu – ne mogu svi da budu iz svih opština ljudi i da kažu ja poznajem ovoga ili ne poznajem. Mi ćemo se vrtiti u krug a imamo zaista potrebu. Ja govorim znači još jednom za čoveka iz Dragaša. Ponekad se desi da ne budemo na Skupštini i smatram da taj čovek zaista može da bude za sudiju, to je moje mišljenje, to ćete čuti od ljudi koji znači rade u tom sudu. Danas u суду u Dragašu ima samo jedan sudija. Ja ovo moram da kažem i mogu da govorim iz jednog razloga što sam u tom periodu bio osudjivan 4 meseca zatvora, znači u tom sudu gde je ovaj čovek radio ali znam njegovo ponašanje i prema onima koji su me osudili i kakav je bio njegov stav u odnosu na one koji su osudjivani ili terani sa posla. Hvala.

#### KRYESUESI NEXHAT DÁCI:

Ju falemnderit. Unë nuk po e përsëris, është incizuar vendimi, ju lutem. Të gjitha sygjerimet komisioni përkatës le t'i kërkojë, le të rrespektohen dhe le të grumbullohet materiali i nevojshëm. Mendoj se duhet të deklarohemi sepse ka edhe mendimë që duhet të shkojmë një nga një, prandaj, kush është për atë formulim që të kompletohet dokumentacioni i kërkuar sot dhe pastaj të vjen në shqyrtim.

Ju falemnderit. Të gjithë.  
A ka kush kundër? Askush.  
A abstenon ndokush nga votimi? Një abstenim.

---

**Votimi – Glasanje – Voted:**

Për – Za – For .....	Të gjithë – Svi – All
Kundër – Protiv – Against .....	00
Abstenim – Uzdržanah – Abstained .....	01

---

Para se të përfundojmë duhet t'ju njoftoj dhe se ju do ta merrni ftesën edhe me shkrim që sot një javë do të ketë seancë plenare, në vend të të enjtës. Dhe një informatë për ju zoti Kurteshi e veçantë. Në këtë Parlament derisa të udhëhiqet nga unë, nuk do të shtrohen debate e çështje të pagrumbulluara në aspektin material dhe dokumentativ. Në atë moment kur ky Parlament të merrë vendim si do të monitorohet, unë nuk po e hudhi përbajtjen e kërkesës, por kur të kemi ne për çka të diskutojmë, atëherë do të jetë i hapur. Jo pa e dijt përçka, sepse institucionet e Kosovës janë fuqishëm në monitorim të përhershëm që prej krijimit dhe nuk e dijmë çka ka modalitete të reja.

E dyta. Derisa Rektorati i Universitetit dhe ministria përkatëse nuk ndërmarrin diç, nuk mund në çdo reagim të debatajë Parlamenti. Do të thotë, le të përgatitet, do të jenë në shqyrtim të gjitha. Ad hoc për ta konfrontuar një grup parlamentar ose një grup politik me tjetrin unë nuk do të jam as sot e as nesër. Prandaj i keni të gjitha rrugët demokratike dhe ndërmerrni çka të doni.

Ju falemnderit për pjesëmarrje.

**Seanca përfundoi në orën 12.55.**